



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 6567/Prot.

Tirane, me 02.11 2016

**DEKLARATE MJEDISORE**  
*per Vleresimin Strategjik Mjedisor*

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, leshon kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani i Pergjithshem Vendor per Bashkine Berat

Kerkuesi: Bashkia Berat

Kufijte e zones qe mbulon plani: e gjithë siperfaqja e bashkise Berat se bashku me njesite e saj administrative

Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

Qendrimi i Ministrise:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapesine dhe duke zbatuar te gjitha masat e nevojshme zbutese, te gjitha grup-projektet jane te pranueshme nga kendveshtrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese te interesit ka kontribuar ne cilesine e vleresimit, ka sjelle te dhena per analizen dhe raportin e VSM-se dhe do te mbeshtese zbatimin e planit pas miratimit te tij, si dhe do te kontribuojte ne nje pranim me te lehte dhe me te zbutur te projekteve perkates.

Ndikimet e mundshme ne mjedis te planit

Gjate zbatimit te projekteve/veprimeve, priten te ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet positive priten per ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe per popullatat dhe asetet materiale. Vleresimi i rezultateve tregon se nuk do te kete impakte mbi faktoret klimatike

duke konsideruar qe mjetet e transportit do te vijojne te rinovohen ne te ardhmen edhe me tej, gje qe do te sjelle si pasoje permiresim te cilesise se ajrit dhe cilesise se shendetit human, midis te tjerave. per me tej ne pjesen positive te impakteve mbi popullaten dhe asetet materiale do te vije si rezultat i zbatimit te infrastruktures ne pergjithesi qe do te beje te mundur pakesimin e kohes se udhetimit, sigurine ne levizje, perafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe sherbimet publike ne pergjithesi.

Pergjithesisht, shumica e impakteve negative jane te lidhura me fazen e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures ne hapesine dhe pergatitja e kushteve teknike te pershtatshme), pasi Shqiperia ka vecori te theksuara diverse dhe te shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi qe mund te ndikohen konsiderueshem prej zhvillimeve te infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje te gjere dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, uje, etj.). Impaktet negative shfaqen ne fazen e planifikimit prej aspekteve te perdorimit te tokes, efekteve ne uje, natyre (si biodiversiteti edhe zonat me status te mbrojtur), trashegimine kulturore dhe peisazhin. Keto impakte do te kerkojne krijimin e nje programi bashkekohor mbi masat zbutese dhe nje zbatim te pershtatshem te ketyre masave. Impakte negative mbi shendetin human mund te ndodhin per shkak te rritjes se ndotjes nga zhurmat dhe impaktet ne cilesine e ajrit, vecanerisht ne zonat me densitet te larte banimi ku do te perqendrohen edhe nje seri veprimesh ne territor te ngushte dhe kjo do te ndikojte kryesisht ne fazen e zbatimit te projekteve specifike.

#### Vleresimi i perputhshmerise se objektive:

Ne pergjithesi, ne kendveshtrimin e perputhshmerise me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, jane si me poshte:

Objektivat Mjedisore te PPV-se per Bashkine Berat paraqiten:

- me perputhshmeri te larte mjedisore: ne masen 40.32%
- me perputhshmeri te pjesshme: ne masen 56.45%,
- me ndikim te theksuar ne mjedis 3.23% e nderhyrjeve te parashikuara

Ne kendveshtrimin e lidhjes mes objektive te Planit dhe objektive mjedisore, verehet nje perputhshmerise e pjesshme e pare ne kontekstin e pergjithshem ku sipas fushave perkatese mjedisore, intensitetin me te madh te ndikimeve ne mjedis e marrin nderhyrjet e forta ne terren siç jane ato te zhvillimit te infrastruktures urbane dhe rurale.

Perputhshmeria e projekteve te planit me objektivat mjedisore:

1. Ne total, nga 59 projekte te PPV-se, 31.1% e tyre kane perputhshmeri te larte me objektivat mjedisore. Pra ndikimi qe keto projekte do te kene ne mjedis do te jete i paperfillshem dhe, ne disa raste, ato jane hartuar si nje domosdoshmeri e rehabilitimit te gjendjes mjedisore per Bashkine Berat.
2. Rreth 47.2% e fondit te projekteve kane perputhshmeri mesatare, çka nenkupton se ndikimi i tyre do te jete i ulet dhe mund te zbutet ndjeshem me marrjen e masave te parashikuara ne legjislacionin shqiptar (masat percaktohen gjate hartimit te raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis) gjate fazes se zbatimit. Monitorimi i ketyre masave eshte element kyç ne ruajtjen e nivelit te perputhshmerise edhe gjate fazes se operimit te ketyre projekteve.
3. Vetem 5.3% projekteve nga 77 qe jane propozuar ne Planin e Bashkise Berat kane perputhshmeri te zbehte. Ne kete rast qofte respektimi qofte monitorimi i perpikthe i

masave shtrenguese mjedisore nuk do te sillte neutralizim te plote te ndikimeve, por thjesht do te kufizojte me zbutjen e ndikimit te projekteve tek objektivat mjedisore.

4. Projektet e vleresuara me perputhshmeri neutrale kane te bejne kryesisht me hartime planesh, studime, investime dhe ngritje kapacitetesh njerezore. Pra projekte dhe nderhyrje te cilat bartin nje ndikim mjedisor me peshe fare te vogel krahasuar me nderhyrjet fizike. Ndaj edhe vleresimi i tyre eshte faktorizuar si neutral.
5. Nuk ka asnje projekt, nga i gjithë fondi me perputhshmeri negative me Objektivat Mjedisore. Megjithate, Plani perfshine edhe projekte qe parashikojne nderhyrje te fuqishme fizike ne territor. Si rrjedhoje, edhe ndikimi i tyre ne perberes specifike te mjedisit si ajer, uje, zhurma, etj., parashikohet te jete mjaft shqetesues dhe, ne disa raste, edhe me ndikim shkaterrues.

Pra, ne teresi, Plani i Pergjithshem Vendor i Bashkise Berat mund te zbatohet plotesisht ne terren dhe te jete miqesor me mjedisin vetem duke respektuar standardet, kushtet dhe masat specifike mjedisore qe do te rrjedhin nga vleresimi specifik i secilit projekt.

#### **Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:**

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjithë fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.
- Bashkia Lushnje, nen mbikqyrjen e Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit, qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te planit mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte efciente ne perdorimin e energjise, si perdorimi i teknologjive izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdorimit te ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukurore te parashikuara ne Plan te sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri, dhe rritjen e perfitimeve per perdoruesit e kesaj infrastrukture.
- Plani duhet te nxite realizimin e projekteve te impianteve te trajtimit te ujrave te perdorur urbane dhe ne nje shkalle me te gjere duke e shtrire kete mase edhe ne aktivite e tjera industriale qe krijojne shkarkime ujrash industriale te ndotura dhe qe ndikojne sidomos ne cilesine e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore. Te projektohet infrastrukture bashkekohore dhe afatgjate te kanalizimeve te ujrave te ndotura urbane.

- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me kuadrin ligjor per mbrojtjen e natyres, duke respektuar shkallen e mbrojtjes se zones apo nenzones se mbrojtur ku do te nderhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve qe gjenden ne zone, si dhe te komunikohet/bashkepunohe me AdZM per te marre masat e domosdoshme per mos cenimin e statusit te ketyre zonave.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te projekteve/aktiviteteve specifike individuale te Planit duhet te perfshihen masa qe do te lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore. Ne rastin kur projektet qe do zbatohen mund te prekin zona te Mbrojtura apo mund te ndodhen ne afersi te tyre.
- Plani te marre masa per promovimin e transportit publik te pasagjereve qe te kontribuojne ne pakesimin e shkarkimeve ne ajer.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Ne asnje rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te zonave te mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet ne ajer dhe zhurmat ndikojne ekosistemet dhe habitatet e llojeve nen mbrojtje. Promovimi brenda dhe ne periferite e zonave te mbrojtura duhet te jete ngritja e infrastrukturave te lehta qe mbeshtesin aktivitetet pa makina, ne drejtim te sporteve dhe aktiviteteve ne natyre.
- Hartimi i planeve te menaxhimit te trafikut krahas prioritizimit te zonave te gjelberta publike, duhet te paraprijne planet urbane te zhvillimit dhe te kene objektiva te matshme per cilesine e ajrit.
- Te merren masa per mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore qe gjenden ne zonen ne studim.
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit, vemendje e vecante te kushtohet per integrimin e zonave te sigurise nga permbytjet dhe atyre ligatinore, nderkohe qe masat e pyllzimit te synojne stabilizimin e humbjeve e tokes nga permbytjet (te zbatohet duke perdorur lloje te bimesise autoktone qe i rezistojne edhe permbytjeve).
- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Plani duhet te parashikojte kapacitete me te medha per landfillet ekzistuese dhe se pari ndertimi i landfillleve te reja teknologjike duhet te paraprije investimet ne kete.
- Ne teresi, projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peisazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar „best practices“.
- Gjate implementimit te planit te vihen ne zbatim masat zbutese e propozuara ne raportin e VSM-se per minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative ne mjedis.

#### **Detyrime dhe sanksione:**

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te planit eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.

- › Nese plani nuk eshte miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit te deklarates, atehere deklarata behet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj te varesise, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se plani nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin pergjegjes per zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershem te zbatimit deri ne sqarimin e situates.
- › Nese pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standardet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qellim qe te permbushen standardet mjedisore.
- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.

**Lefter KOKA**



**MINISTRI**